



### Viti 2024 solli 11,7 milionë vizitorë të huaj në Shqipëri

01

11,7 milionë vizitorë të huaj vizituan Shqipërinë gjatë vitit 2024, ose 15,2% krahasuar me vitin 2023, tregues se Shqipëria po përjeton një rritje të qëndrueshme në nivel fluksesh hyrëse, si dhe ka konsoliduar një ofertë turistike dhe të diversifikuar. Përtej rritjeve të hyrjeve turistike nga vendet e rajonit, viti 2024 ka konfirmuar rritje dhe qëndrueshmëri të tregjeve nga Evropa Perëndimore si Italia, Gjermania, Franca apo Britania e Madhe dhe ka zgjeruar hartën e tregjeve të largëta e ka afruar më shumë vizitorë prej tyre.



### Shqipëria merr pjesë në panairin FITUR Madrid 2025

02

Shqipëria mori pjesë në panairin global të turizmit Fitur 2025 në Madrid nga data 22 deri më 26 janar, përmes agjendës së organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, stenda e së cilës u konceptua si një buqetë e ndjesive, përvojave dhe shijeve që Shqipëria ofron duke e prezantuar si destinacionin më emocionues në Europë: që nga eksplorimet virtuale të vendit, tek "Albanian Nights", e menutë e degustimit të ofruara nga Shoqata Shqiptare e Agroturizmit.



### Shqipëria dhe Spanja me projekte të përbashkëta në turizëm

03

Gjatë panairit "FITUR 2025", ministrja Mirela Kumbaro pati një tryezë diskutimi me Ministrin spanjoll të Industrisë dhe Turizmit Jordi Hereu si edhe me Sekretaren e Shtetit për Turizmin, Rosario Sánchez Grau për projekte të përbashkëta në inovacion, digjitalizim dhe përgatitje të burimeve njerëzore. Viti 2024 u mbyll me gati 110 mijë vizitorë spanjollë ose 26% më shumë se vitit paraardhës. Gjatë qëndrimit në Madrid, ministrja Kumbaro u takua edhe me Sekretarin e Përgjithshëm të UNETO, Zurab Pololikashvili për të çuar përpara projektet e përbashkëta.



### Sezoni i mbjelljeve, vijojnë aktivitetet pyllëzuese në bashkitë e vendit

04

Vijojnë aktivitetet e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, stafet e administratave rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe bashkive për mbjelljen e fidanëve sipas kalendarit të pyllëzimeve. Viti i Pyjeve ishte një nisim dhe suksesshëm që mobilizoi gjithë bashkitë e vendit, institucionet, organizimet vullnetare dhe sektorin privat në veprimtari gjithëpërfshirëse për pyllëzime, aktivitete edukimi, marrëveshje bashkëpunimi e publikime shkencore, me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre pasurive të çmuara.



### 5.5 milionë vizitorë në Zonat e Mbrojtura gjatë Vitit 2024

05

5,5 milionë vizitorë kanë shijuar parqet tona natyrore e kombëtare gjatë vitit 2024, ose 1 milionë më shumë se viti 2023, si një shembull i interesit në rritje për ekoturizmin, sportet e natyrës si ecja në shtigje, rafting apo ngjitjet në mal, por edhe kuriozitetit për të njohur biodiversitetin. Shqipëria ka përqafuar qasjen e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, ku 22% e territorit janë sipërfaqe që mbrohen si peizazhe të mbrojtura, parqe natyrore apo parqe kombëtare.